



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

Kabineti i Ministrimit

Kabinet ministra

Cabinet of the minister

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

### Zbatimi i Strukturës së re të shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët të muzikës

NUMËR : 34/2009

DATË:2.11.2009

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6.1 paragrafi (d), 12.2 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, si dhe nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

#### Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i strukturës së reformuar të shkollimit profesional të muzikës (niveli i parë dhe i dytë) për vitin shkollor 2009/2010.

#### Neni 2 Struktura e re e shkollimit muzikor

- 1.. Struktura e re e shkollimit muzikor 4 + 4 përfshin :shkollën fillore të muzikës ( 4 vite) dhe shkollën e mesme të ulët të muzikës (4 vite). Viti 2009/2010 lejohet si vit tranzicioni drejt zbatimit të plotë të strukturës së re të arsimit muzikor në vitin shkollor 2010/2011.
2. Planet dhe programet mësimore të shkollës fillore dhe të mesme të ulët të muzikës janë në proces të rishikimit.

#### Neni 3 Zbatueshmëria


1. Me zbatimin e strukturës së re të arsimit muzikor, nxënësit regjistrohen në shkollën e muzikës:piano dhe harqe-kur e përfundojnë klasën e parë të shkollës fillore të rregullt; frymorë-kur e përfundojnë klasën e tretë të shkollimit të rregullt.

2. Nxënësit e përfundojnë shkollën fillore të muzikës me mbarimin e klasës së katërt (në të gjitha drejtimet) dhe marrin certifikatën përkatëse për mbarimin e nivelit të parë-shkollës fillore të muzikës.
3. Të drejtë për vazhdim në shkollimin e mesëm të ulët kanë vetëm nxënësit, mesatarja e përgjithshme e të cilëve për nivelin e parë vlerësohet me notë nga 3.5 -5.
4. Për t'u regjistruar në shkollën e mesme të ulët të muzikës, nxënësit i nënshtrohen provimit pranues në shkollë.
5. Me zbatimin e strukturës së re mësimore të këtyre dy niveleve të shkollimit muzikor, shfuqizohet struktura e mëparshme.

#### 4. Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

  
Enver Hoxha, ministër



## 1 STRUKTURA E SISTEMIT TË ARSIMIT PROFESIONAL MUZIKOR

<sup>1</sup> Vërejtje: numrat në katrorët e bardhë paraqesin klasët e shkollës fillore të përgjithshme të cilat korrespondojnë me klasët përkatëse të shkollimit muzikor:

**Instrumentet me harqe dhe me tastierë** fillojnë klasën e parë paralelisht me klasën e dytë të shkollës fillore të përgjithshme prej vitit të ardhshëm shkollor 2008/2009. Deri më 2015, klasa e fundit mbetet klasa e VII-të.

**Instrumentet me frymë** regjistrohen në klasën e parë kur ata kanë përfunduar klasën e tretë të shkollës fillore.